KËRKESË
Nr.2764/1, datë 11.11.2008

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i stacionit të pompimit Tushemisht.

Subjekti kërkues i këtij objekti është sh.a. ujësjellës-kanalizime, Pogradec. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen e titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 62 490 (gjashtëdhjetë e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë) lekë.

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË STACIONIT TË POMPIMIT, TUSHEMISHT, POGRADEC

Nr.	**Emri**	**Atësia**	**Mbiemri**	**Zona kadast.**	**Nr.pas.**	**Lloji i pas.**	**Sip m^2**	**Çmimi m^2/lekë**	**Vlera (lekë)**
1.	Hil	Ndoc	Hila	3664	4/8	Tokë/arë	100	624.9	62 490